



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 96

Tiranë – E mërkurë, 29 qershor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 53/2022, datë 23.6.2022	Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit ‘Për verifikimin e mënyrës së zbatimit të ligjit nr. 55/2015, ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’”..... 12281
Vendim i Kuvendit nr. 54/2022, datë 23.6.2022	Për zgjedhjen e zotit Durim Kraja anëtar të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 12281
Vendim i Kuvendit nr. 55/2022, datë 23.6.2022	Për zgjedhjen e zonjës Leida Matja anëtare të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 12281
Rezolutë e Kuvendit datë 23.6.2022	Për vlerësimin e punës së Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2021..... 12282
Dekret i Presidentit nr. 13717, datë 23.6.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12283
Dekret i Presidentit nr. 13718, datë 23.6.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12284
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 119/1, datë 7.6.2022	Për miratimin e Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës..... 12284
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 1009, datë 28.6.2022	Për delegim kompetencash..... 12284
Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 197, datë 22.6.2022	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 12285

**VENDIM
Nr. 53/2022****PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTVENDIMIT “PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT HETIMOR TË
KUVENDIT ‘PËR VERIFIKIMIN E
MËNYRËS SË ZBATIMIT TË LIGJIT
NR. 55/2015, ‘PËR INVESTIMET
STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe
nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen
e komisionit hetimor të Kuvendit ‘Për verifikimin e
mënyrës së zbatimit të ligjit nr. 55/2015, ‘Për
investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë””.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 23.6.2022.

**VENDIM
Nr. 54/2022****PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT DURIM
KRAJA ANËTAR TË KOMISIONIT
TË AUTORITETIT TË
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të
neneve 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9121, datë
28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të
ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së
Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Zoti Durim Kraja zgjidhet anëtar i Komisionit
të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 23.6.2022.

**VENDIM
Nr. 55/2022****PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS LEIDA
MATJA ANËTARE TË KOMISIONIT
TË AUTORITETIT TË
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të
neneve 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9121, datë
28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të
ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së
Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Zonja Leida Matja zgjidhet anëtare e
Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 23.6.2022.

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E PUNËS
SË DEPARTAMENTIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR
GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR VITIN 2021****Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

- Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

- Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtejshëm të reformës së administratës publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2021 në drejtim të:

- Realizimit të detyrave dhe aktiviteteve/nënaktiviteteve që parashikon Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën Publike (2018–2022).

- Grupimit të pozicioneve vakante bazuar në përshkrimin e punës.

Shtirjes së Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) në institucionet e administratës publike ku puna vijoi *online*.

- Krijimit dhe shpërndarjes në rrjetet sociale dhe kanalin *YouTube* të DAP-it, video përshkruese për përmbajtjen dhe funksionimin e platformës së bashkëpunimit “administrata.al”.

- Përmirësimit të disa moduleve në platformën “administrata.al”, si: moduli i hartimit të përshkrimeve të punës, moduli i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, moduli i raportimit mujor.

- Transparencës së punës së DAP-it dhe rritjes së numrit të qytetarëve të interesuar nëpërmjet komunikimit në rrjetet sociale krahas faqes zyrtare që tregon rritje të besimit të publikut ndaj institucionit.

- Veprimtarisë së shtuar nga ana e institucioneve për të përmirësuar procesin e planifikimit të nevojave për rekrutim.

- Zhvillimit të takimeve rajonale dhe trajnimit të 372 nëpunësve civilë nga njësitë e burimeve njerëzore, legjislacionit dhe të financave, të 58 bashkive në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- Plotësimit të vendeve vakante sipas planit vjetor të pranimit në pozicione pune për vitin 2021 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil.

- Kryerjes së procedurave të lirimimit nga shërbimi civil të nëpunësve civilë sipas legjislacionit në fuqi, duke shmangur proceset e parregullta dhe kostot financiare të vendimeve gjyqësore.

- Menaxhimit të mirë të çështjeve në kuadër të ndjekjes së proceseve gjyqësore.

- Rishikimit të strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës shtetërore gjatë vitit 2021 bazuar në nevojat e tyre për një organizim më të mirë të punës dhe rialokim më të mirë të burimeve njerëzore në dispozicion me qëllim rritjen e eficiencës dhe efikasitetin në administratën publike.

Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të përgatisë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore për procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, strukturën e pagës, përmirësimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës, përmirësimin e metodologjisë së vlerësimit të rezultateve të punës, pezullimit, lirimimit, transferimit, me qëllim përmirësimin e përcaktimeve ligjore për këto çështje.

2. Të hartojë një manual për planifikimin vjetor të burimeve njerëzore, si dhe të bashkëpunojë me të gjitha institucionet e administratës shtetërore duke krijuar një plan pune të zbatueshëm për përmirësimin e procesit të planifikimit vjetor të nevojave për rekrutim sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.2.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

3. Të vijojë aplikimin e trajnimeve *online* për administratën vendore për procedurat e popullimit të sistemit HRMIS dhe platformës “administrata.al”.



4. Të ndjekë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj gjyqfituesve, si dhe marrjen e masave nga ana e institucioneve për të mbajtur sa më të ulët numrin e ankesave të reja.

5. Të angazhohet në hartimin e bazës ligjore dhe funksionimin e platformës “administrata.al”.

6. Të rrisë ndërveprimin me qytetarët nëpërmjet publikimit në portalin *online* të aplikimit, të informacioneve që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.

7. Të krijojë një hapësirë të dedikuar në faqe për seksionin pyetje-përgjigje për palët e interesuara, institucionet publike apo individë për interpretimin e dispozitave të legjislacionit në fushën e shërbimit civil dhe administratës publike.

8. Në zbatim të udhëzimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për zbatimin e detyrimeve të administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, të hartohen plane pune monitorimi dhe të paraqiten raporte analitike për përmbushjen e detyrimeve të nëpunësve civilë dhe institucioneve që punësojnë nëpunës civilë gjatë periudhës zgjedhore.

9. Të sigurojë një vlerësim sa më objektiv gjatë procesit të rekrutimit për të gjithë nëpunësit civilë, duke shtuar vëmendjen tek ata me profil arsimor në fushën e drejtësisë, si edhe të garantojë një trup nëpunësish civilë me performancë të lartë në të gjitha nivelet e administratës nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme, me qëllim rritjen profesionale, veçanërisht për punonjësit të cilët kanë një profil arsimor në drejtësi.

Miratuar në datën 23.6.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

DEKRET
Nr. 13717, datë 23.6.2022

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 6, 8 e 20, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bujar Nazim Ramnabaja
2. Medina Veton Musolli (Jaha)
3. Arian Xhevdet Tara
4. Fedaim Atim Ajazaj
5. Fortuna Dashnor Xërxa Shalqini (Xërxa)
6. Ymran Nazmi Blyta (Dragidella)
7. Bukuriye Vebi Memaj (Sadikaj)
8. Xhelbrim Isen Sope
9. Elvir Bajram Murati
10. Artan Syreja Hapçiu
11. Hirije Emurlla Gjelo-shgjakaj (Mustafi)
12. Armend Syreja (Sureja) Hapçiu
13. Deshir Sali Kadriaj
14. Alba Ali Selimaj
15. Ilir Vebi Sadikaj
16. Tefta Sali Xharra (Kollodra)
17. Lirije Ali Hapçiu (Hisari)
18. Endrit Besnik Hoxhaj
19. Rudina Ali Selimaj
20. Vjollce Liman Fetoshi (Spahija)
21. Nikki Byron Glenn Doçi (Jo Nordby)
22. Rida Abdellah Arjaoui
23. Sevim Ayhan Harja (Coşar)
24. Remzi Xhevit Toçilla
25. Morellys Isabel Celestino Antonio Jordan Reyes

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



DEKRET
Nr. 13718, datë 23.6.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 16 e 20, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Olsion Gjenci (Gjenci) Parangoni
2. Pal Mark Ndoj
3. Elton Kristaq Ikonimi
4. Jorgaq Dhimitri Koruni
5. Sofika Thodhoraq Xhima
6. Helton Arben Kosturi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR
Nr. 119/1, datë 7.6.2022

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT
TË PRAKTIKËS KLINIKE
PËR SHËRBIMIN E ORTHOPTIKËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 19.1.2022, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2022”, si edhe në

urdhrit nr. 119, datë 17.2.2022, “Mbi hartimin e Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës”, me qëllim zbatimin në praktikë të Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Udhërrëfyesit të Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës (në format elektronik CD), sipas listës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri, përgatitur nga grupi i punës i ngarkuar për këtë qëllim.

2. Ngarkohet gjithë personeli mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor publik, që në praktikën e përditshme mjekësore të udhëhiqen nga Udhërrëfyesi i Praktikës Klinike për Shërbimin e Orthoptikës.

3. Ngarkohen drejtorët e spitaleve dhe përgjegjësit e shërbimeve për njohjen dhe pajisjen e shërbimeve me Udhërrëfyesin e Praktikës Klinike të Shërbimit të Orthoptikës, si edhe ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

4. Ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, Drejtorja e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorja e Përgjithshme e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Mira Rakacolli

URDHËR
Nr. 1009, datë 28.6.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “F”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 28, 29 dhe



113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mbrojtjes, zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga zëvendësministri i Mbrojtjes menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Zëvendësministri i Mbrojtjes nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

5. Urdhri nr. 373, datë 29.3.2022, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi

URDHËR
Nr. 197, datë 22.6.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”; të nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të

Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit, z. Enton Sadiku.

2. Z. Enton Sadiku i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (e ndryshuar);

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 27.6.2022 deri 1.7.2022.

4. Z. Enton Sadiku nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta, një për Protokoll/Arkivin, një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit dhe një për QBZ-në.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë